



ELISA SPIROPALI

Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Jetëshkrimi:

Znj. Elisa Spiropali është zgjedhur Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë gjatë Legjislaturës X, prej 30 korrikut 2024.

Znj. Spiropali ka një karrierë të spikatur politike, parlamentare dhe qeverisëse.

Prej janarit 2019 deri në korrik 2024, ka shërbyer si ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, duke u riemëruar në mandatin e tretë qeverisëse të Partisë Socialiste, në shtator 2021.

Znj. Spiropali po shërben në mandatin e dytë si deputete e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 është zgjedhur deputete e Qarkut të Korçës, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2021 është zgjedhur deputete për Qarkun e Tiranës.

Para emërimit në detyrë si Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin, znj. Spiropali ka mbajtur funksionin e nënkryetares së Grupit Parlamentar Socialist dhe të nënkryetares së Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, prej vitit 2017 deri në vitin 2019.

Znj. Spiropali ka një karrierë të spikatur në Partinë Socialiste, ku bën pjesë prej vitit 2009. Është anëtare kryesie dhe drejtuese politike në Partinë Socialiste.

Znj. Spiropali ka një formim solid dhe ekselent akademik dhe universitar.

Ka kryer dy vitet e para të shkollimit të mesëm në gjimnazin “Qemal Stafa” në Tiranë për të vazhduar më pas në “Lester B. Pearson College”, United World College (UWC) of the Pacific, në Kanada, pasi fitoi bursën si një nga pesë gjimnazistet më të mira në Shqipëri.

Pasi fitoi Bursën në “Mount Holyoke College” (2001), ndoqi studimet e larta në Massachusetts, SHBA ku u diplomua në vitin 2005 me dy tituj nderi në dy degë universitare Ekonomi (Economics) dhe Politikë (Politics). Një semestër e kreu në Buenos Aires, në programet e shkëmbimit me bursë ekselence nga Universiteti “Mount Holyoke College” për studimin e krizës ekonomike Argjentinase.

Në vitin 2007 fitoi bursën “Chevening/OSI” për studime pasuniversitare në Contemporary European Politics, në Universitetin “Sussex” në Britaninë e Madhe.

Znj. Elisa Spiropali është lindur në Tiranë, më 15 mars 1983.

Ajo është e martuar dhe jeton në Tiranë, me bashkëshortin, Salarjonin, dhe dy fëmijët, Naltën dhe Krenin.